



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Glllogoc, me 06.09.2017



RAPORT PËR MUAJIN GUSHT 2017

Gjatë këtij muaji kemi vazhduar me rëndësi të veçantë inspektimin e bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë në Drenas për taksë komunale dhe Inspektime për rendin e udhëtimit të transportuesve legal.

Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori Sanitar në veqanti ka inspektuar subjektet hoteliere dhe furrat e bukes për kushtet higjienike si dhe marketet rreth afatizimit të artikujve ushqimor.

Inspektori i Ndërtimit ka vazhduar me kontrollë të ndërtimeve pa leje, inspektime sipas kërkeses gjatë fazave të ndërtimit me leje dhe është bërë rrënim i 4 objekteve përmes Kompanisë kontaktuese (2 objekte montazhë në rr.Fehmi dhe Xhevë Lladrovci dhe 2 objekte të stacioni i vjetër i autobusave).

Inspektori i Komunikacionit ka bërë kontrollë të Operatorëve ilegal duke vazhduar me masat ndëshkuese-fletëparaqitje dhe rendin e udhëtimit të transportuesve legal.

Inspektorët e Tregut kanë inspektuar në veqanti tregtarët lëvizës dhe largimin e tyre nga shitja në vendin jo adekuat si dhe janë urdhëruar bizneset për tu pajisur me pëlqim për ushtrimin e veprimtarisë.

Inspektori Financiar ka vazhduar me inspektim të bizneseve rreth kryerjes së obligimeve të takses komunale.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime në shqyrtim të kërkesave të qytetarëve si dhe urdhëresë për ato subjekte të cilat nuk janë kyqur në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Në vazhdim po paraqesim një pasqyrë të punës në shifra për muajin gusht 2017:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktvendime	Fletëparaqitje	Gjaba mandat.	Kërkesa	Pëlqim për biznes	Shqyrtim i Kërkesave	Rrënim i objekteve
I.Sanitare	27			6	3	3		
I.Tregut	25	3						
I.Financiare	66							
I.komunikacionit	18		10					
I.Ndërtimit	24	5		2				4
I.Ambientit	37			6	18		18	
Gjithsej	197	8	10	14	21	3	18	4

Shtator 2017

Shef i Inspekcionit: ARIANA SADIKU